



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. "George Bush", Ndërtesa e Rektoratit, Nr. 31, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot: 651
Data: 27 / 3 / 2025

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 20, pika 2, nënpika 2.1, si dhe nenin 91 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 26.03.2025, mori këtë:


V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores së Përgjithshme të Studimeve të Doktoratës në Universitetin e Prishtinës, e miratuar në mbledhjen e Senatit të datës 21.02.2025

- I. Plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores së përgjithshme të doktoratës bëhet te neni 7, pika 6, neni 9, pika 1.1 dhe pika 5, të cilat riformulohen si në vijim:
 - 1.1 Neni 7, pika 6, riformulohet: *Koncepti ideor i hulumtimit duhet të prezantohet para komisionit për vlerësimin e aplikantëve. Ky komision caktohet nga këshilli i fakultetit për secilin program dhe përbëhet nga anëtarë që i plotësojnë kriteret për mentorim. Komisioni bën vlerësimin e konceptit ideor, i cili duhet të përfshijë së paku komponentët në vijim: (...)*
 - 1.2 Neni 9, pika 1.1, fjalia brenda kllapave riformulohet (*si autor i parë, autor korrespondent ose bashkautor*).
 - 1.3 Neni 9, pika 5, riformulohet: *Një mentor mund të marrë për udhëheqje më së shumti dy doktorantë të regjistruar brenda një viti akademik, por jo më shumë se tre (3) doktorantë njëkohësisht. Përgjithësisht, një profesor mund të marrë për udhëheqje edhe deri në dy (2) kandidatë shtesë, nëse kandidatët ekzistues kanë kaluar dyfishin e kohës së paraparë për përfundimin e studimeve dhe nëse kandidatët janë të punësuar me orar të plotë në një projekt shkencor që realizohet në UP.*
- II. Dispozitat tjera të Rregullores së përgjithshme të doktoratës mbesin të pandryshuara.
- III. Plotësimet dhe ndryshimet sipas këtij vendimi bëhet pjesë integrale e Rregullores së Përgjithshme të Doktoratës, të miratuar në mbledhjen e Senatit të UP-së me datë 21.02.2025.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij në Senat.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Zyrës Ligjore të UP-së;
3. Zyrës për Çështje Akademike;
4. Njësive akademike të UP-së;
5. Zyrës për Çështje të Studentëve.



Kryesuesi i Senatit të UP-së

Arben Hajrullahu, Rektor